



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12,16 dhe 17 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale NR.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 të datës 04.06.2008, si dhe nenit 9 paragrafi 9.1 të Ligji nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Statutit të Komunës së Lipjanit NR.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.06.2026, pas shqyrtimit të propozimit Vendimit mori këtë:

VENDIM

PËR RRITJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT NGA TEJKALIMI I TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2025

Neni 1.

Me këtë Propozim Vendim të bëhet rritja e planifikimit të buxhetit të të hyrave vetanake në shumë prej 737,770.18€ Kështu që vlera e të hyrave vetanake të planifikuara nga 3,174,047.00€ rritet në 3,911,817.18€.

Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi planifikohen të destinohen si vijon:

Mallra e Sherbime:

Shërbimet e Shëndetësis Primare(730) Programi (73200).....	53,397.50€
Arsim dhe shkencë(920) Programi-92250	37,509.50€
Totali	90,907.00€

Shpenzime komunale:

Arsim dhe shkencë(920) Programi-(92250).....	5,000.00€
Totali	5,000.00€

Shëndetsi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi –(73200)

53192 Ndertimi i qendres urgjente ne qytetin e Lipjanit.....

146,640.00€

Totali.....146,640.00€

Shërbimet kulturore (850)-Programi (85003)

54338 Ndërtimi i Qendres multifunksionale në qytetin e Lipjanit

495,223.18€

Totali 495,223.18€

Totali i rritjes së të hyrave vetanake për vitin 2025 në krahasim me planifikimin e buxhetit është 3,911,817.18€.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Neni 5.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Nr. 15-40061-29390

Lipjan, më 30.06.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi